



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.592/6 prot.

Tiranë, më 16.05.2023

REKOMANDIM

Nr. 30, datë 16.05.2023

PËR KONTROLLUESIN “DHL INTERNATIONAL ALBANIA SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “DHL International Albania SHPK” (në vijim, “Kontrolluesi ose DHL”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 43, datë 15.03.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi ushtron aktivitetin e shërbimeve postare me të gjitha mjetet e transportit: me tokë, det, rrugë ujore dhe ajrore të brendshme dhe përgjithësisht bën pjesë në çdo aktivitet tregtar industrial, financiar, pasurie të luajtshme ose të paluajtshme, të lidhura drejtpërdrejt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht me objektin e saj, ose që mund të kontribuojë në zhvillimin e realizimit të tyre. Në përmbushjen e objekteve të saj, kompania ka të drejtë të kryejë aktivitetin tregtar, si agjent transportues, çarter, spedicioni dhe transporti, si dhe të veprojë si agjent zhdoganimi, etj.

2. Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “*klientë*”, “*punonjës*”, “*vizitorë*”, “*kandidatë për punë*”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

Nga verifikimi rezulton se, Kontrolluesi është përfaqësues zyrtar i DHL International për Shqipërinë. Konstatohet se, Kontrolluesi ndër të tjera, gjatë ushtrimit të aktivitetit përdor disa platforma informatike, të tilla si: “*GEMA*”, “*MYDHL*”, etj. Këto platforma janë të ofruara nga “*DHL International Europe*”, nëpërmjet domain-eve <http://gema.dhl.com>, <https://mydhl.express.dhl>, si dhe në modulet specifike të tyre. Konstatohet se në këto platforma dhe në modulet informatike respektive të tyre, Kontrolluesi ka attribute si administrator për territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shërbimet e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të portaleve të mësipërme, ku përfshihen dhe platforma informatike “*GEMA*” dhe “*MYDHL*”, nuk kryhen nga Kontrolluesi, por nga “*DHL International*”.

“*DHL International Albania*” krijon dhe administron çdo llogari të agjentëve në modulet informatike. Gjithashtu konstatohet se, për çdo problematikë teknike dhe funksionale që shfaqet gjatë operimit të platformave “*GEMA*” dhe “*MYDHL*”, Kontrolluesi i drejtohet për shërbim “*DHL International*”.

Konstatohet se, të dhënat e “*kandidatëve për punë*” ruhen pa afat në arkivën elektronike të Kontrolluesit. Këto dokumentacione ruhen nga Kontrolluesi, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në germën “*d*”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit, Udhëzimin nr.11, datë 08.09.2011 “*Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 11*”) si dhe Udhëzimin nr. 42, datë 22.07.2014 “*Për përpunimin e të dhënave personale të kandidatëve për punë*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 42*”).

Në sportelin e informacionit të godinës ku Kontrolluesi ushtron aktivitetin, ruhen në regjistra fizik që prej vitit 2015, të dhënat: “*Emër, mbiemër, numër identiteti (në vijim, “NID”), nënshkrimi, etj.*”, të subjekteve “*vizitorë*”.

Sa i përket ruajtjes së NID të vizitorëve, rezulton se kjo e dhënë mblidhet në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të parashikuar në germën “*c*”, të pikës 1, të nenit 5 dhe kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në nenin 6 të ligjit.

Gjithashtu, sa i përket kohës së ruajtjes së të dhënave të subjekteve “*vizitorë*”, në regjistrat fizikë që administron Kontrolluesi, rezulton se këto të dhëna ruhen në tejkalim të afatit të parashikuar në “*Udhëzuesin për pritjen e vizitorëve*”, si dhe në kundërshtim me parimin e parashikuar në germën “*d*”, të pikës 1, të nenit 5 dhe nenit 6 të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar, duhet të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet ligjore specifike dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave.

Gjithashtu, kategoritë e të dhënave të mbledhura/ruajtura në regjistrin e të dhënave të individëve/vizitorëve që aksesojnë ambientet e Kontrolluesit, duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim, si dhe mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se këto konstatime janë në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave të sanksionuara në gerrat “c” dhe “d” të pikës 1, të nenit 5, si dhe kriteret ligjore të përpunimit të parashikuar në nenit 6 të Ligjit.

Kontrolluesi disponon një sistem video-survejmimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, për qëllim të sigurisë së nëpunësve dhe aseteve. Megjithatë, konstatohet se dhe pse ka tabela njoftuese mbi prezencën e sistemit të video-survejmimit (CCTV), ato nuk përmbajnë elementët informues, sipas modelit standard të tabelës informuese të miratuar nga Zyra e Komisionerit, në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit “*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejmimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Sa më sipër, Kontrolluesi nuk informon qartësisht subjektet, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejmimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Nga verifikimi në sistemin e video-survejmimit (CCTV), konstatohet se të dhënat imazhe-video ruhen për një periudhë 77 ditore (nga 04.01.2023 deri më 21.03.2023), në kundërshtim me parimin e parashikuar në germen “d”, të pikës 1, të nenit 5 të ligjit si dhe parashikimin e pikës 4/c të Udhëzimit nr. 3, i cili përcakton se: “*Periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video survejmimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të*

video survejimit do ruhen për një periudhë deri në dy muaj dhe pas kalimit të kësaj periudhe të dhënat do të fshihen..”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi mund të përpunojë të dhënat imazhe-video të subjekteve të të dhënave nëpërmjet sistemit të video-surveimit (CCTV), për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin ato janë grumbulluar. Në momentin që qëllimi ka përfunduar, kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e të dhënave imazheve-video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm, referuar parashikimit të gurmës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

3. Kontrolluesi ka lidhur Kontrata/Marrëveshje me palë të treta, të tilla si, kontratë bashkëpunimi me *“Insig sh.a.”*, nr. 32 prot., datë 31.01.2023, me objekt: *“...Përcaktimin e kushteve dhe afateve të bashkëpunimit mes palëve për sigurimin e jetës dhe shëndetit nga aksidentet për punonjësit e policëmbajtësit, sipas kushteve, afateve...”*; marrëveshje e datës 29.12.2022 me *“First LLC sh.p.k.”*, për *“Instalimin, implementimin, suportin dhe trajnim për implementimin e sistemit CCTV”*; kontratë për shërbimin e fiskalizimit me *“Tetra Solution sh.p.k.”*, nr. 1 prot., datë 17.01.2022, midis *“DHL International Albania sh.p.k.”*, si dhe kontratë me agjenci tregtare nëpërmjet *“DHL International Albania sh.p.k”* dhe *“H. Z., person fizik”*.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtyre kontratave, marrëveshjeve të sipërcituara, rezulton se në to, nuk janë reflektuar detyrimet, sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit duhet të përfshihen në marrëveshjet/kontratat dhe/ose aneks kontratat e nënshkruara mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing/shërbimi*) që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale, duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë Përpunuesi, për të siguruar/garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre në çdo hallkë të këtij përpunimi.

4. Nga verifikimi i kryer në Regjistrin Elektronik të Subjekteve Kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezulton se Kontrolluesi ka *“Njoftuar”* mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është konstatuar se *“Njoftimi”* ka mangësi në deklarinë, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 3, të formularit të njoftimit “*kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si “*vizitorë*”;
- ii. Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “*kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si “*emër, mbiemër, nr. telefoni, adresa e klientit, leje drejtimi, gjeolokalizimi*”;
- iii. Deklarimin në rubrikën 5, të formularit të njoftimit “*të dhënat sensitive që përpunohen*”, të tilla si: “*dëshmi penaliteti*”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 6, të formularit të njoftimit “*qëllimi i përpunimit*”;
- v. Deklarimin në rubrikën 7, të formularit të njoftimit “*Marrësit e të dhënave personale*” të tilla si: “*Insig sh.a.*”, “*First LLC sh.p.k.*”, “*Tetra Solution sh.p.k.*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së Njoftimit të përpunimit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep Ligji.

5. Kontrolluesi nuk ka hartuar “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Konstatohet se, Kontrolluesi disponon një grup politikash të miratuara nga shoqëria DHL International dhe shoqëria Deutsche Post DHL, lidhur me sigurinë e informacionit. Konkretisht, kontrolluesi disponon:
 - *DHL measures concerning the EU General Data Protection Regulation (GDPR);*
 - *Deutsche post DHL manual data privacy policy;*
 - *AL - Reception - Process Activity Discovery GDPR;*
 - *AL - IT - Process Activity Discovery GDPR;*
 - *Information Security Code of Practice;*

- *ISMS - Information Security Management System;*
- *Information Security Compliance Monitoring Guideline;*
- *EXP IS Risk Assessment Guidelines, etj.*

Konstatohet se masat e ndërmarra janë jo të plota në raport më veprimtarinë e gjerë që kryen Kontrolluesi, sikurse edhe grupi i politikave që disponon, nuk aplikohen dhe dokumentohen gjatë ushtrimit të aktivitetit, pasi ky set politikash i atribuohet kompanisë DHL International dhe nuk parashikojnë proceset përpunuese që kryhen nga DHL International Albania Shpk.

Gjithashtu, konstatohet mosplotësimi i detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 47”*), për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Konkretisht, konstatohet se mungojnë elementë të tjerë të sigurisë së të dhënave si, *“Dokumentimi i proceseve të politikave të miratuara nga Kontrolluesi”*, *“Analizë e ndikimit në të dhëna personale”*, *“Sigurinë e personelit dhe pajisjeve elektronike të lëvizshme ose jo”*, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Konstatohet se Kontrolluesi ka ndërmarrë masa sa i përket trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në kuadër të politikave të grupit. Megjithatë, nga verifikimi i prezantimeve trajnuese, rezulton se në përmbajtje të tyre nuk i referohen legjislacionit shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesit e Kontrolluesit u paraqiten në seancën dëgjimore të datës 27.04.2023, të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe kanë shprehur qëndrimin e tyre, konkretisht:

- Lidhur me konstatimin se: *“të dhënat e kandidateve për punë në arkivin elektronik si dhe të dhënat e vizitorëve në regjistrat fizik ruhen pa afat”*, Kontrolluesi pretendon se *“...nuk është në kushtet e shkëljes së dispozitave të sipërcituara ...”*.

Lidhur me këtë pretendim të Kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron pasi, në arkivin elektronik të njësisë së burimeve njerëzore rezultojnë CV të subjekteve të të dhënave *“kandidatë për punë”*, të periudhës nëntor 2022.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përcaktimi i afateve kohore duhet të jetë i parashikuar konkretisht në akte të brendshme rregullatore/politika, etj. Kontrolluesi duhet të identifikojë rast pas rasti kategoritë e të dhënave që përpunon dhe duhet të përcaktojë afatet e ruajtjes së këtyre të dhënave në aktet e veta të brendshme rregullatore, në përputhje me qëllimin e grumbullimit.

Gjithashtu, kategoritë e të dhënave të mbledhura, në regjistrin e të dhënave të individëve/vizitorëve që aksesojnë ambientet e Kontrolluesit duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, qëllimin e përpunimit, dhe në mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

- Lidhur me konstatimin se: *“...kontrolluesi nuk ka parashikuar kërkesat ligjore të nenit 20 të Ligjit dhe të Udhëzimit nr. 19, konkretisht, lidhur me kontratat/marrëveshjet me palët e treta...”*, Kontrolluesi argumenton se *“...janë zbatuar detyrimet midis palëve sipas kontratave/marrëveshjeve...”*

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk qëndrojnë pasi, përmbajtja e neneve që citon kontrolluesi nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave nga Përpunuesit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në mënyrë që këta të fundit, të garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Gjithashtu, referuar pikës 2 të nenit 20 të ligjit, detyrimet e pikës 1 të këtij neni, duhet të parashikohen në kontratën e shkruar midis kontrolluesit me përpunuesit.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuadër të garantimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe garantimit të ligjshmërisë së përpunimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave, të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, të marrë masa për shkatërrimin e të dhënave të ruajtura/mbledhura në tejkalim të qëllimit të përpunimit për të cilat janë mbledhur;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale për të gjitha proceset përpunuese, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, në zbatim të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, dhe të monitorojë në vijimësi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjet me përpunuesit, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;

8. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- (i) brenda 5 (pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 1 më sipër;
- (ii) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 më sipër;
- (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 4 dhe 5 më sipër;
- (iv) brenda 45 (dyzet e pesë) ditë, detyrimet e treguara në pikat 6 dhe 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

10. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 16.05.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi